

**MONITORIM I MEDIAVE  
KANABISI NË SHQIPËRI 2009-2020**

**Dr. Valmora Gogo**

**Tiranë, Mars 2020**

## **Përmbajtja**

1. Qëllimi i studimit	3
2. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore	4
3. Metodologjia	5
4. Të dhëna mbi asgjësimine kanabisit në Shqipëri, 1995-2019	5
5. Analiza e të dhënave sasiore për raportimet mediatike mbi kanabisin dhe drogat e tjera në Shqipëri, 2009-2020	7
6. Analiza e të dhënave cilësore për raportimet mediatike mbi kanabisin dhe drogat e tjera në shqipëri, 2009-2020	11
7. Përfundime dhe Rekomandime	22
8. Bibliografia	25
9. Shtojca	26

## **1.QËLLIMI I STUDIMIT**

Raportimet në mediat shqiptare mbi kanabisin dhe drogat e tjeranë territorin shqiptar apo operacionet ndërkombëtare kanë qenë prezente vitet e tranzicionit. Pyetjet që lindin janë në çfarë sasive? Sa të shpeshta? Në cilat medie? Cilat janë zonat kryesore ku është kultivuar kanabisi në Shqipëri sipas raportimeve mediatike? Në çfarë frekuence ka ndryshuar fluksi i numrit të lajmeve në vite? Cilat kanë qenë periudhat kur është rritur fluksi i lajmeve dhe i opinion/komenteve mbi drogat? A ka korrelacion mes rritjes/uljes së këtij fluksi raportimesh dhe rritjes/uljes së fluksit të sasive të asgjësuar të kanabisit?

Qëllimi i këtij studimi është zbulimi se si mediat kanë raportuar mbi kanabisin dhe drogat e tjera, duke monitoruar dhe analizuar raportimet mediatike në llojet kryesore të kanaleve të informimit mediatik në vend: televizione, gazeta dhe medie online. Përzgjedhja e këtyre medieve është menduar të bëhet mbi bazën e kritereve të tilla si qëndrueshmëria mediatike (kohëzgjatja e ekzistencës së mediave), rëndësia që i kushtojnë raportimit profesional, madhësia e audiencave të tyre dhe impakti që kanë në opinionin publik.

Në studim fokusi do të jetë te zbërthimi i përgjigjeve edhe për katër pyetje të tjera thelbësore:

### **1. Cilat janë sjelljet popullore rreth kultivimit të kanabisit në Shqipëri?**

### **2. A kanë ndryshuar opinionet në kohë?**

### **3. Cilat lloj zgjidhjesh që propozohen?**

### **4. Cili është roli i shoqërisë civile?**

Lajmet standarde dhe produkte si speciale, reportazhe, editoriale/analiza/komente/opinione etj, që janë monitoruar në këtë studim kanë në qendër trajtimet e drogave të tilla si kanabisi<sup>1</sup>, heroina, kokaina etj. Paraprakisht duhej periodizuar tranzicioni shqiptar, kryesisht 10 vitet e fundit, sidomos sa i përket zhvillimeve rreth kanabisit, duke e ndarë dhjetëvjeçarin e fundit, 2009-2020, në 4 periudha më të vogla:

#### **1. 2009-2013 (Para Lazarat)**

#### **2.2014-2015 (Lazarati)**

#### **3.2015-2016 (Përhapja në gjithë Shqipërinë)**

#### **4.2017-2019 (Çështja Saimir Tahiri/Debatet)**

Periodizimi paraprak ishte i nevojshëm jo vetëm për një ndarje logjike sipas fazave të zhvillimit të kësaj problematike duke u marrë me raportimin mediatik në këto momente por po ashtu për monitorimin e frekuencës së fluksit të këtyre lajmeve.

---

<sup>1</sup>Produktet mediatike janë kërkuar edhe me fjalëkyçe të tjera si “marijuana” përveç kanabisit duke qenë sinonim i së njëjtës drogë apo “hashash” meqë është përqëndrim i marijuanës.

Le të qëndrojmë pak te shenjimi i periudhave. “Para Lazarat” dhe “Lazarat” u atribuohet raportimeve dhe ngjarjeve të periudhës së parë dhe të dytë të 10 viteve të fundit, ku pika e referencës ka qenë zona e Lazaratit dhe operacionet policore atje në vitet 2013-2014 dhe periudha para operacioneve policore intensive në këtë fshat. Ndërkohë që vitet 2015-2016 shenjojnë përhapjen e fenomenit të mbjelljes në gjithë Shqipërinë të kanabisit, duke marrë si referencë raportimet mediatike dhe komunikatat e institucioneve si Policia e Shtetit apo raporte të “Guardia di Finanza”-s. Në këtë periudhë paraprakisht mund të themi se kemi një tendencë në rritje të njoftimeve të Policisë së Shtetit për asgjësimin e kanabisit por po ashtu edhe ndeshje me ulje të operacioneve policore në të gjithë vendin. Vitet 2017-2019 shoqërohen me çështjen ligjore të ish-ministrit të Punëve të Brendshme Saimir Tahirit, ku një prej akuzave që i rëndonte ishte ajo e trafikut ndërkombëtar të drogës si dhe më tej ulja e raportimeve mbi kanabisin në gjithë Shqipërinë, ulja e numrit të njoftimeve të policisë mbi asgjësimin apo një dakordësi në opinionin publik se fenomeni është zvogëluar<sup>2</sup>.

## **2.HIPOTEZA DHE PYETJET KËRKIMORE**

**Hipoteza e studimit ka të bëjë me konstatimin se raportimi mbi kanabisin dhe drogat e tjera është i pranishëm në mediat në Shqipëri në 10 vitet e fundit. Raportimi mediatik mbi kanabisin lidhet me sasinë e asgjësuarë të kanabisit të komunikuar nga Policia e Shtetit apo institucione të tjera.**

**Pyetjet kryesore kërkimore do të përqëndrohen në këtë bosht:**

1. Cila është sasia e lajmeve mbi kanabisin dhe drogat në Shqipëri? Në çfarë frekuence ka ndryshuar fluksi i numrit të lajmeve në vite?
2. Cilat kanë qenë periudhat kur është rritur fluksi i lajmeve dhe i editorialeve/opinion/komenteve mbi drogat?
3. A ka lidhje mes rritjes së këtij fluksi raportimesh dhe fluksit të sasive të asgjësuarë të kanabisit sipas raportimeve zyrtare të Policisë së Shtetit apo institucioneve të tjera?
4. Cilat janë zonat kryesore ku është kultivuar kanabisi në Shqipëri sipas raportimeve mediatike? Si është zgjeruar apo ngushtuar harta?
5. Si qëndron raporti mes lajmeve të zakonshme, specialeve, editorialeve, analizave, komenteve dhe opinionëve? Cilat medie shkruajnë dhe çfarë, çfarë hapësire u japin këtyre përmbajtjeve, çfarë rëndësie u japin raportimeve të tilla? Janë tema kryesore apo periferike? Cilat janë zgjidhjet e ofruara për frenimin e problematikës nga shoqëria civile?

---

<sup>2</sup>Zvogëlohet numri i bimëve të asgjësuarë, zvogëlohet numri i raportimeve mediatike, zvogëlohet numri dhe thellësia e debateve publike apo shkrimeve analitike. Konkluzion i nxjerrë nga një njohje dhe ndjekje paraprake e problematikave.

### 3.METODOLOGJIA

Metodologjia e këtij studimi përqëndrohet te gërshetimi i metodave që na mundësojnë mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Për këtë do të përdoret **monitorimi**, kryesisht për të dhënat sasiore dhe cilësore parësore duke përdorur përveç të dhënave parësore edhe ato dytësore si raportet e “Guardia di Finanza”-s, komunikime të ministrit të Punëve të Brendshme Sandër Lleshaj apo burime konfidenciale. Një vend shumë të rëndësishëm në metodologji zë **analiza**, jo vetëm për vërtetimin e hipotezës së ngritur por edhe për interpretimin e fluksit dhe frekuencës së editorialeve/analizave/opinioneve/komenteve dhe zgjidhjes që ofrojnë analistë të ndryshëm, pjesë e shoqërisë shqiptare. Zbërthimi i interpretimeve të tyre do të sjellë një ide edhe mbi atë që mund të mendojë shoqëria në përgjithësi, duke qenë se autorët janë edhe përfaqësues të opinionit publik.

Studimi bazohet te një kërkim dhe njohje paraprake e raportimeve për këtë tematikë për shkak të ekspertizës si studiuese dhe përvojës si gazetare e kryeredaktore në mediat në Shqipëri<sup>3</sup>.

Përzgjedhja e mediave për monitorim u bë mbi bazën e llojit të kanalit të informimit (televizion, gazetë, media online), rëndësisë që këto medie i kushtojnë raportimit profesional, qëndrueshmërisë, madhësisë së audiencave që këto media kanë dhe impaktit që kanë në opinionin publik. Për këtë u mendua të monitorohen “**A1 Report**”<sup>4</sup>, “**Panorama**”<sup>5</sup> dhe “**Balkanweb.com**”<sup>6</sup> për një periudhë 10-vjeçare. Përzgjedhja e medieve për monitorim varej gjithashtu edhe nga analiza të mëparshme mbi trajtimin në media të operacioneve të kanabisit dhe debatet mbi të.

Pas monitorimeve të para u vu re se “A1 Report” dhe “Balkanweb.com” kishin mungesa të theksuara në arkivat përkatëse. Zgjidhja e kësaj situatë u bë duke vazhduar monitorimin për 10 vite të të gjitha raportimeve, specialeve, kryeartikujve, opinion/komenteve në një prej gazetave kryesore në Shqipëri, “Panorama”. Arkiva e kësaj gazete ishte e e plotë. Në monitorim janë marrë 2 muaj për çdo vit nga 2009 deri në 2020-ën: marsi dhe tetori. Në total janë monitoruar 18 muaj në këtë gazetë.

### 4. TË DHËNA MBI ASGJËSIMIN E KANABISIT NË SHQIPËRI, 1995-2019

Nga burime konfidenciale mësohet se në vitin 1995 në Shqipëri janë asgjësuar 167 mijë rrënjë kanabis, në vitin 1996-ën 384 mijë rrënjë dhe një vit më pas në 1997-ën vetëm 800 rrënjë.

Të dhënat nga këto burime të sigurta tregojnë se prirja e asgjësimit ka qenë e tillë në vitet pasardhëse: 1998-62 mijë rrënjë, 1999- 91 mijë rrënjë, 2000-256 mijë rrënjë, 2001-281 mijë rrënjë, 2002- 285 mijë rrënjë, 2003- 168 mijë rrënjë, 2004- 73 mijë rrënjë.

---

<sup>3</sup>Rreth 15 vjet: gazetare e “Shekulli”-t, “Panorama”-s, “A1 TV”, “Newsbomb.al”, “Shuplaka.com”, “Hashtag.al” etj.

<sup>4</sup> Televizion dhe grup mediatik i fokusuar te lajmet e kronikës së zezë.

<sup>5</sup> Gazetë e qëndrueshme në kohë dhe me evidence për fokus në raportim profesional. E përqëndruar edhe te përfaqësimi i zërave të shoqërisë shqiptare.


<sup>6</sup> Një nga agjencitë e para online shqiptare. E qëndrueshme dhe e përqëndruar te raportimi profesional. Zakonisht mediet e tjera shqiptare e përdorin si kanal furnizues me informacion duke vlerësuar saktësinë dhe shpejtësinë.

Sipas të dhënave të “Guardia di Finanza”-s, bimët e asgjësuara nga 2005-a deri më 2013-ën në Shqipëri janë: 2005- 332 mijë, 2008-145 mijë rrënjë, 2009-152 mijë rrënjë, 2010-27 mijë rrënjë, 2011-21 mijë rrënjë, 2012- 76 mijë rrënjë, 2013-98 mijë rrënjë.

Po sipas raportit të “Guardia di Finanza”-s<sup>7</sup>nga 2013-a deri në 2018-ën bimët e asgjësuara janë: **qershor-korrik** 2013-14 mijë e 772 rrënjë bimësh pa përfshirë Lazaratin, **qershor-shtator** 2014-46 mijë e 605 duke përfshirë Lazaratin, **qershor-14 shtator** 2015-242 mijë e 945 rrënjë kanabis, **qershor-15 shtator** 2016- 753 mijë e 468 rrënjë kanabis, **15 maj-15 shtator** 2017- 4844 rrënjë kanabis dhe nga **4 prilli në 31 tetor** 2018-675 rrënjë kanabis. Vihet re që të dhënat nuk janë vjetore për këtë periudhë të tranzicionit.

Megjithatë ministri i Punëve të Brendshme, Sandër Lleshaj raportoi në Kuvend<sup>8</sup> se numri i bimëve të asgjësuara të kanabisit në vitin 2019 ishte 90 mijë rrënjë kanabis.

Grafiku më poshtë tregon të vizualizuar kurbën e numrit të bimëve të asgjësuara të kanabisit në Shqipëri sipas viteve, ku shihet që numri më i lartë i asgjësimit ka ndodhur në vitin **2016**, (duke llogaritur që bëhet fjalë për shifrat e vetëm 3 muajve e gjysmë)<sup>9</sup> dhe më i ulëti në **1997-ën**.



**Figura Nr.1. Grafiku i bimëve të asgjësuara të kanabisit në Shqipëri sipas viteve**

Këto të dhëna do na ndihmojnë që pasi të monitorojmë edhe detajet rreth raportimit mediatik të vërtetojmë hipotezën e ngritur ose ta hedhim poshtë atë.

<sup>7</sup><https://exit.al/2017/11/raporti-i-gdf-se-2017-zbulohen-me-pak-plantacione-kanabisi-ne-shqiperi-por-kapet-me-shume-droge-shqiptare-ne-itali/>

<sup>8</sup>Fjalim i ministrit Sandër Lleshaj në Kuvendin e Shqipërisë më 12 shkurt 2020

<sup>9</sup>Nga viti 2013 deri në 2018-ën raporti i “Guardia di Finanza”-s nuk është i plotë për të gjithë muajt e çdo viti, megjithatë të dhënat krijojnë një ide mbi dimensionin e problematikës, sidomos kur krahasohet me periudha më të hershme,

## **5. ANALIZA E TË DHËNAVE SASIORE PËR RAPORTIMET MEDIATIKE MBI KANABISIN DHE DROGAT E TJERA NË SHQIPËRI, 2009-2020**

Le të rendisim në këto dy çështje të dhënat e përftuara nga monitorimi i medieve të shënjestruara, me qëllim që të kalojmë më tej në një analizë të thelluar. Ato kanë të bëjnë me:

-**Numrin e raportimeve të zakonshme** në mediat e zgjedhura për lajmet me fjalëkyçe drogë, kanabis, marijuanë, hashash, kokainë, heroinë.

-**Numrin e kryeartikujve për lajmet** me këto fjalëkyçe.

-**Numrin e lajmeve të ekspozuara në faqen e parë të gazetës** së përzgjedhur me këto fjalëkyçe.

-**Numrin e lajmeve të dyta pas kryeartikullit në faqen e parëtë gazetës** së përzgjedhur me këto fjalëkyçe.

-**Numrin e specialeve** për këto fjalëkyçe.

-**Numrin e editorialeve/analizave/komenteve/opinioneve** për çështje me këto fjalëkyçe.

-**Emrat e analistëve që kanë shkruar për çështje** me këto fjalëkyçe.

-**Zonat e përmendura në Shqipëri në raportimet mediatike ndër vite** me këto fjalëkyçe.

Analizimi i këtyre të dhënave në çështjet pasardhëse do na mundësojë nxjerrjen e disa përfundimeve sipas qëllimit të paracaktuar të studimit. Të dhënat e siguruar nga monitorimi janë paraqitur në grafikë, ndërsa tabelat e detajuara gjenden te shtojcat.

Siç shihet në grafikun më poshtë nga 2015-ta në 2020-ën raportimet mediatike mbi këtë problematikë janë në trend rritës. Për **“A1 Report”** është thujse dyfishuar numri i lajmeve kurse për **“Balkanweb.com”** thujse 10-fishuar. Nuk mund të gjendet arsyeja pse; nëse ka të bëjë me arsye teknike të mungesës së lajmeve të 2015-ës në arkivat e tyre, fshehje të komunikimit apo raporteve mbi problematikën nga institucionet, komunikatat dhe burimet e të cilave furnizojnë këto media apo një liri më e madhe redaksionale për ta raportuar problematikën në vitet më pas.


**Zonat e përmendura në raportimet e vitit 2015 për kanabisin dhe drogat e tjera** në këto medie janë: Lazarati, Korça, Italia, Britania e Madhe, Fieri, Xibraka, Kufiri Itali-Greqi, Genova, Kukësi, Lushnja, Tirana, Belgjika, Kruja, Delvina, Elbasani, Gjirokastra, Mallakstra, Vlora, Kakavija, Shkodra, Brindisi, Tepelena, Gjirokastra, Berati, Greqia, Fushë-Kruja, Tropoja<sup>10</sup>.

**Në vitin 2020** konstatojmë: Italinë, Bashkimin Europian, Britaninë e Madhe, Bolonjën, Londrën, Kamzën, Tiranën, kufirin Shqipëri-Itali, Memaliajn, Greqinë, Qafë-Botën, Brazilin, Mirditën, Shijakun, Stunin e Italisë, Livornon, Mamurrasin, Durrësin, destinacionin Karaibe-Greqi, Lazaratin, Tiranën, kufirin grek, Kosturin, Rrëshenin, destinacionin Shqipëri-Holandë, Europën, Firenzen, Bolonjën, Shkodrën, Konispolin, Vlorën, Manastirin, Hasin, Konispolin, Holandën,

---


<sup>10</sup> Te tabelat te shtojcat gjenden detajimet sipas periudhave.

Gjermaninë, zonën Himarë-Livadh, Lezhën, Mallakastrën, Shijakun, Xibrakën, Elbasanin, Tepelenën, Paskuqanin, Korçën, Bilishtin, Fierin.



**Figura Nr.2 Grafiku i frekuencës së lajmeve për drogat në 2 muaj, janar 2020 dhe qershor 2015. Shqipëri: “A1 Report” dhe “Shqiptarja.com”, “Balkanweb.com”, “Panorama”**

Nevoja lind që të shohim më gjerë ndryshimin e frekuencave të lajmeve mbi tematikën, në të gjithë periudhën e 10-vjeçarit. Për këtë do t’u referohemi të dhënave që na sjell monitorimi i detajuar i gazetës “Panorama”. Grafiku më poshtë tregon numrin e raportimeve standarde profesionale mbi kanabisin dhe drogat e tjera nga viti 2009 deri në 2020-ën në Shqipëri. Pika më e ulët e grafikut është **tetori i 2010-ës**, me vetëm 8 lajme, ndërsa tri më të lartat sipas rendit zbritës janë **tetori 2018, tetori 2017 dhe tetori 2016**. Një pikë kulmore, qëduhet vënë re është janari 2020.



**Figura Nr.3 Grafiku i frekuencës së lajmeve mbi drogat në Shqipëri në gazetën “Panorama”**



Në funksion të vërtetimit të hipotezës së ngritur në këtë studim apo hedhjes poshtë të saj na duhet të krahasojmë dhe të analizojmë me kujdes format e dy grafikëve, atë të kanabisit të asgjësuar nga viti 2009 deri në 2019 me atë të numrit të lajmeve për kanabisin dhe drogat nga 2009 në 2019 (në gazetën “Panorama” duke qenë se është e vetmja me arkivën e plotë). Këtu vërejmë se forma e dy grafikëve në disa periudha është e ngjashme. Kuptohet, një diferencë bën edhe zbritja në llogaritje që duhet t’u bëjmë lajmeve për drogat e tjera si kokaina dhe heroina, megjithëse monitorimet tregojnë se ato zënë një përqindje shumë më të vogël në raport me lajmet për kanabisin.

Te dy grafikët **kemi rritje të ngjashme nga 2015-ta në 2016-ën** në numrin e bimëve të sekuestruara të kanabisit dhe numrin e lajmeve për këto problematika në gazetën “Panorama”. Ndërsa kemi **kontrast të rëndësishëm mes formave së grafikëve nga 2016-ta deri në 2019-ën. Nga 2016 deri në 2018-ën kemi ulje të asgjësimit të kanabisit në Shqipëri, ndërsa kemi rritje të raportimit të lajmeve mbi kanabisin dhe drogat.**


**Arsyet** pse ndodh kjo mbeten për t’u hulumtuar në studime të ardhshme por mund të hamendësojmë, edhe bazuar te përvoja se mund të lidhen me mungesën e komunikatave të Policisë së Shtetit dhe fshehjen e problematikës nga ky institucion ose institucione të tjera, mund të kenë të bëjnë fokusin e gazetës “Panorama” dhe hulumtimin duke përdorur burime të tjera për problematikën apo arsye të tjera. Në fakt duhet studiuar edhe futja e lajmeve mbi drogat e tjera pasi në vitet 2014 dhe 2020 kemi lajme të shpeshta edhe mbi kokainën dhe heroinën, megjithëse siç e thamë më lart janë në përqindje shumë më të vogël se ato për kanabisin.

**E kundërt është forma e grafikut edhe nga 2018-ta në 2019-ën. Në këtë periudhë rritet numri i bimëve të asgjësuar por ullet numri i lajmeve.** Arsyet sërish mund të hamendësohen se kanë të bëjnë me mungesën e saktë të statistikave për asgjësimet, me mungesën e komunikatave të Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera për aksionet, me humbjen e interesit të gazetës për çështjen, me mungesën e interesit të opinionit publik gjë që influencon edhe interesin e gazetës etj.

Monitorimi i gazetës “Panorama” na jep një situatë të detajuar edhe mbi elementë të tjerë, përveç numrit të lajmeve. Aty gjejmë informacion të vlefshëm mbi raportin mes lajmeve të zakonshme dhe kryeartikujve apo mes kryeartikujve dhe lajmeve të shfaqura në faqen e parë por po kështu gjejmë një informacion të detajuar mbi opinionet dhe emrat e opinionistëve që i kanë shkruar, për të cilët do shërbejë analiza cilësore. **Numri i artikujve të ekspozuar në faqen e parë konstatohet se vjen në trend rritës, nga 2009-ta në 2020-ën.** Kjo tregon se për gazetën tematika e kanabisit dhe drogave të tjera sa vjen dhe bëhet edhe më e rëndësishme.

Për periudhën 2009-2013 numri i artikujve të ekspozuar në faqen e parë kulmon me **34-ën**, ndërsa në periudhën 2016-2020 kulmon me **163**. Kjo tregon se për gazetën tematika e kanabisit dhe drogave të tjera sa vjen dhe bëhet edhe më e rëndësishme.

Sa u përket kryeartikujve dhe specialeve, edhe ky një informacion me vlerë për rëndësinë e çështjes, konstatohet numri më i lartë në tetor 2017, 4 të tilla dhe i specialeve **në tetor 2016, 12** të tilla.



**Figura Nr.4 Dy format e grafikëve për analizën e lidhjes mes tyre**

Një informacion tjetër me rëndësi është edhe ai për emrat e zonave të ndeshura në raportime të zakonshme mbi tematikën<sup>11</sup>, ku vihet re një **trend rritës i numrit të tyre nga 2009-ta në 2018-**

<sup>11</sup> Shiko tabelat për detaje të mëtejshme.

ën, duke zbritur në dy vitet e fundit: 2019 dhe 2020. Duhet patur në vëmendje që të njëjtat zona mund të jenë përmendur në disa shkrime, në ditë të ndryshme<sup>12</sup>.

**Nga analiza e formave të dy grafikëve konkludojmë se hipoteza vërtetohet. Pra është e vërtetë që raportimi mbi kanabisin dhe drogat e tjera është i pranishëm në mediat në Shqipëri në 10 vitet e fundit. Raportimi mediatik mbi kanabisin lidhet me sasinë e asgjësuar të kanabisit të komunikuar nga Policia e Shtetit apo institucione të tjera.**

## **6. ANALIZA E TË DHËNAVE CILËSORE PËR RAPORTIMET MEDIATIKE MBI KANABISIN DHE DROGAT E TJERA NË SHQIPËRI, 2009-2020**

Për të realizuar një analizë të thelluar na është dashur patjetër të evidentojmë dhe interpretojmë edhe elementët e përmbajtjes së produkteve mediatike. Duke qenë se na nevojitet t'i përgjigjemi pyetjes se si kanë ndryshuar opinionet në kohë për këtë tematikë, jemi përqëndruar te editorialet, opinionet, komentet dhe analizat që janë gjetur në të trija mediet e marra në shqyrtim. Në mendje duhet të mbajmë edhe ndikimin e linjës editoriale që ka patur “Panorama” dhe mediet e tjera, duke qenë se kjo gjë ndikon edhe në mënyrën se si përzgjedhen këta artikuj. “Panorama” nuk shquhet për publikimin e qëndrimeve redaksionale se sa për publikimin e opinionëve, komenteve apo

---

<sup>12</sup>Në gazetën “Panorama” ndeshim këto zona të Shqipërisë apo shtete të tjera të përmendura në raportimet mediatike:

2009 Tiranë, Elbasan.

2010 Gjirokastrë, Kurbin, Elbasan, Tiranë, Fier, Durrës, Sarandë, Shijak, Librazhd, Itali, Berat, Lazarat.

2011 Greqi, Berat, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë (Ura e Drashovicës), Elbasan, Sarandë, Tiranë, Itali, Ndroq (droga nga Lazarati), Lazarat, Elbasan, Qafë-Thanë, Lazarat, Qafë-Botë, Romë, Marikaj, Athinë.

2012 Tiranë, Elbasan, Sarandë, Shkodër, Durrës, Itali, Lazarat, Gjirokastrë, Porti i Durrësit, Kakavijë, Hani i Hotit, Igumenicë, Belgjikë, Durrës, Shkodër, Tiranë, Janinë, Shkrel, Konispol.

2013, Lazarat, Vlorë, Sarandë, Kakavijë, Bilisht, Kapshticë, Itali, Gjirokastrë (droga nga Lazarati), Greqi, Durrës, Shkodër, Dibër, Korçë, Tiranë (Greqi-Shqipëri), Vlorë, Kakavijë, Elbasan, Lazarat, Igumenicë.

2016 Mat, Ishëm, Kepi i Rodonit, Tiranë, Vlorë, Shkodër, Tepelenë, Durrës, Itali, Fier, Sarandë, Tragjas, Shëngjergj, Lalz, Krujë, Fag (afër Dajtit), Muriqan, Greqi, Gjirokastrë, Fier, Igumenicë, Mallakastër, Kurbin, Mamurras, Dukagjin, Farkë, Tiranë, Përmet, Kukës, Vlorë, Gjirokastrë, Durrës, Kakavijë, Akërnë, Ish-Bllok, Fushë-Krujë, Korçë, Lezhë, Elbasan, Tepelenë, Berat, Kufi me Greqinë.

2017 Durrës, Itali, Tiranë, Laknas, Kufi me Malin e Zi, Siçili, Elbasan, Vlorë, Babicë, Luzat, Rinas, Karaburun, destinacioni Shkodër-Pistoja, Devoll-Korçë, Ankona, Gjirokastrë, Sazan, Skrapar, Shkodër, Krujë, Lezhë, Fier, Kakavijë, Zvërnec, Krujë, Muriqan.

2018 Greqi, Fier, Vlorë, Kamzë, Tiranë, Gjermani, Has, Shkodër, Durrës, Shkozë, Karaburun, Kolumbi, Lezhë, Itali, Sarandë, fshati Ninesh në Fratar të Fierit, Maminas, Kostur, Krujë, Gjirokastrë, Korçë, Vlorë, Lazarat, Memaliaj, Elbasan, Spanjë.

2019 Greqi, Elbasan, Brazil, Vlorë, Kavajë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Skrapar, Tiranë, Astir, Fier, Vlorë, Lushje, Lezhë, Korçë, Karaburun, Greqi, Kurbin, Laç.

2020 Itali, Bashkimi Europian, Britania e Madhe, Bolonja, Londër, Kamëz, Tiranë, Shqipëri-Itali, Memaliaj, Greqi, Qafë-Botë, Brazil, Mirditë, Shijak.

analizave nga autorë apo personazhë të implikuar me politikën në Shqipëri. Në gjykimet e qëndimeve që opinionshkrues të tillë mbajnë duhet parë me kujdes edhe backgroundi i tyre.

Nga monitorimi mikro i gazetës dalin informacione të rëndësishme jo vetëm sa u përket të dhënave sasiore, siç është numri i këtyre lloj artikujsh por edhe për të dhënat cilësore që lidhen me përmbajtjen;

- për çfarë kanë shkruar konkretisht,
- me çfarë këndi,
- në çfarë frekuence,
- kur janë periudhat që është intensifikuar qëndrimi i tyre,
- cilët autorë kanë shkruar;
- cilat janë zgjidhjet që ata ofrojnë.

Gjatë studimit konstatohen analiza, editoriale dhe opinione për tematikëm. Në total te to gjenden: viti 2014, “A1 Report”-2 qëndrime redaksionale, viti 2020, gazeta “Panorama”- 4 opinione (autorë Agron Gjekmarkaj, Enton Palushi, Pëllumb Nako, Hamdi Jupe, “Balkanweb.com”- 1 analizë (autor Agron Gjekmarkaj) dhe “A1 Report”- 2 analiza (autor Mero Baze) dhe 1 redaksionale.

Por po të futemi në brendësi të kësaj analize te gazeta “Panorama” dalim në një peizazh të qartë të rëndësishë që u është kushtuar këtyre treguesve. Kryesisht në formën e opinioneve, në 10 vitet e fundit, ndeshim kulminacion të tyre në vitet 2017-2018. Grafiku tregon se kemi një riaktivizim të tyre gjatë muajit janar të këtij viti.




Figura Nr.5 Grafiku i frekuencës së opinioneve mbi drogat në Shqipëri në gazetën “Panorama”

Prirja më e rëndësishme për t'u lexuar është mosekzistenca e tyre për tematikën e kanabisit dhe drogave të tjera që prej vitit 2009 deri në 2016-ën, duke përjashtuar vetëm një rast të konstatuar të një opinion në vitin 2010<sup>13</sup>.

Autorët përgjithësisht konstatojnë prezencën e kultivimit të kanabisit por po kështu bëjnë edhe një diferencim mes periudhash, sa i përket përkeqësimit të situatës. Autorët si dhe personazhe të përfshirë në politikë përcjellin po ashtu shqetësimin e përgjithshëm me të cilin ndeshet shoqëria shqiptare. Ata konstatojnë shkaqe, elementë që e favorizojnë përkeqësimin apo njerëz dhe personazhe që nxisin kultivimin e tij. Përpos tyre, opinionshkruesit japin edhe zgjidhje për reduktimin e fenomenit, duke e konstatuar si të tillë. Ato janë politike, ekonomike, sociale etj. si: dorëheqja e kryeministrit Edi Rama, ngritja e qeverisë së re qoftë edhe teknike, puna më e mirë e Prokurorisë për Krime të Rënda, shkarkimi i drejtuesve të policive në qarqe që dyshohen si të përfshirë në trafik, investimi në zonat e kultivimit të kanabisit, lufta ndaj kanabisit duke kombinuar veprimin e ligjit me politika dhe projekte të vërteta zhvillimi që prodhojnë punë, punësim dhe të ardhura dinjitoze, frenimi i kultivimit të kanabisit me presion nga opozita dhe ndërkombëtarët, investimi i ndërkombëtare në bujqësi, në artizanat, në industrinë përpunuese dhe agroturizëm etj.

Le të kalojmë në sitë mendimet e disa prej autorëve që e kanë shfaqur më dukshëm se kultivimi i kanabisit është kthyer në një fenomen dhe të shohim se çfarë hollësish gjejmë te ta.

## Viti 2010

**-Koli Bele** te “Vetëm për dy gramë “hashash”!” te “Panorama”, mars 2010 konstaton se arrestimet apo ekstradimet për çështje droge janë thuajse të përditshme dhe nuk përbëjnë lajm duke thënë se policia raporton mijëra dhjetra rrënjë kanabis të korrura për çdo fshat. Bele trajton rastin e një djali të ri nga Berati, 18 vjeç që në 2007-ën ishte dënua me 3.4 vite burg për 2.2 gramë hashash. Dënon dënimet e ashpra për krimet e lehta. Nuk është zgjidhje burgimi dhe duhen zbutur politikat e dënimit për drogat e buta.

---

<sup>13</sup>Opinionet dhe komentet te “Panorama” janë thuajse zero nga viti 2009 deri prill 2016, përveç një komenti të Koli Beles, ndërsa rritet numri nga gjysma e dytë e vitit 2016 deri në 2019, përkatësisht me shifrat: tetor 2016- 9 opinione (Tritan Shehu, Gjergj Meta (2), Çapajev Gjokutaj, Preç Zogaj, Roland Qafoku, Ndue Dedaj, Edmond Tupja, Kastriot Islami),

2017- 31 opinione (Preç Zogaj (2), Mentor Nazarko (2), Mark Marku, Koco Kokëdhima, Fatos Lubonja, Luçiano Boçi, Pëllumb Nako, Agron Gjekmarkaj, Romeo Gurakuqi, Pëllumb Nako, Fatos Lubonja (2), Lavdrim Lita (2), Mark Marku (2), Agron Gjekmarkaj (2), Elvis Zaimi, Preç Zogaj (2), Tomor Alizoti, Hamdi Jupe, Dardan Mustafaj, Fitim Zekthi, Romeo Gurakuqi, Qemal Lame, Eduard Halimi, Pëllumb Nako).

2018-25 opinione (Agron Gjekmarkaj (2), Kiço Blushi, Pëllumb Nako (2), Alban Dudushi, Mark Marku, Çapajev Gjokutaj, Preç Zogaj, Fatos Lubonja (2), Mentor Nazarko, Genc Pollo, Luçiano Boçi, Lavdrim Lita, Ergys Mërtiri, Fitim Zekthi, Ndue Dedaj).

2019-5 opinione (Pëllumb Nako, Agron Gjekmarkaj, Rigters Lenja, Romeo Gurakuqi, Desada Metaj).

2020-4 opinione (Agron Gjekmarkaj, Enton Palushi, Pëllumb Nako, Hamdi Jupe).

## Viti 2016

**-Tritan Shehu** (Tetor 2016 “Panorama”) te “Një tempull për kanabisin!” konstaton se vendi është mbuluar nga një burim i bollshëm i kanabisit, ka grupe të armatosur që e mbrojnë këtë lloj droge dhe ironizon duke kërkuar se duhet ngritur një tempull për të. E cilëson tragjedi situatën. Dënon mbrojtjen mediatike të kanabisit sikur ka vlera mjekësore (e hedh poshtë duke përdorur argumente). Kërkon ndryshime në Kodin Penal duke thënë se duhen arrestuar kultivuesit dhe jo përdoruesit në doza të vogla. Sipas tij kanabisi jo vetëm që ndikon për keq në shëndet por edhe sjell dëme shoqërore, korrupsion, kriminalitet, prishje të imazhit, prostitucion etj. Është iluzion, sipas Shehut që kanabisi rrit mirëqënien ekonomike.

**-Gjergj Meta** (Tetor 2016 “Panorama”) te “Tri shtyllat e së keqes” trajton “sëmundjet e shoqërisë shqiptare si krimi, korrupsioni dhe një hapësirë të rëndësishme i lë kanabizimit të vendit dhe mbrojtjes së të rinjve. Për problematikën e kanabisit ai thotë se shumë të rinj sidomos nëpër fshatra janë pjesë e mbjelljes, kultivimit dhe përpunimit të kanabisit. Ai jep rrëfimin se një burim i ka thënë se në një fshat të Laçit ka gra e të rinj që kanë lënë punën në fasoneri sepse përpunimi i bimëve narkotike sipas tij është më me leverdi. “Paguhen nga 2000 lekë në ditë sot në Shqipëri? Janë më shumë se rroga e një mësuesi. Dhe ne presim që njerëz të papunë, të rinj që sillen vërdallë gjithë ditën të mos i pranojnë oferta të tilla? Në më shumë se një rast unë vetë di të rinj që kanë provuar së paku një herë të mbjellin kanabis e në ndonjë rast di që janë gjurmuar nga policia në fshatrat e Krujës jo për t’u kapur por për t’i thënë se janë pa leje”. Kultivimin Meta e quan mëkat ndaj shoqërisë e njeriut. “Por fjalët shpesh bien në tokë ose në veshë indiferentë”, thekson ai. Zgjidhja? “Unë them se duhen të gjithë faktorët bashkë rreth një tryeze, një lloj task force, e cila ka brenda qeverinë, partitë, shoqërinë civile, partnerët ndërkombëtarë, religjionet, OJQ dhe sidomos mediat...”, mendon ai. Sipas Metës zgjidhja është rikthimi te një kulturë jete, një kulturë pune dhe një kulturë ndershmërie në vendin e punës, të cilat zhvillojnë shoqërinë dhe personin njerëzor. “Indiferenca është sëmundja më e keqe e të gjitha sëmundjeve”, përfundon ai.

**-Gjergj Meta** (Tetor 2016 “Panorama”) vazhdon shkrimin e dytë për problematikën e kanabisit me titull “Letër një të riu që merret me kanabis”. “I dashur A.” Sipas Metës të rinjve ju janë ofruar modelet e të fortëve që kanë trafikuar gra e janë marrë me drogë dhe se nuk janë rritur me dashurinë për shkencën, për dijen, për letërsinë. I riu, sipas tij është rritur me tallavanë e jo me muzikën klasike. Varfëria i ka frenuar prindërit e këtij të riu t’ia tregonin muzikën klasike atij sepse nuk siguronin as bukën e gojës. I riu, menduar nga autorit, pa në këtë mënyrë pasojat e përpjekjeve të familjarëve: pa lekë, të rinjtë e shoqërisë punë në Call Center, në kontrast me parakalimet e disa të tjerëve me makina luksoze. “Sot je thjesht një ushtar...”, i shkruan Meta të riut që e supozon se është duke ruajtur një arë me kanabis apo në burg, duke shtuar që “...ka humbur lirinë e vet” sepse u mashtrua nga të fortët me gënjeshtrenë “policia na mbron”. Meta parashikon se ky i ri do arrestohet nga policia por të fortët që e bënë ushtar jo. “...në fund të tunelit ka gjithmonë dritë...jam këtu për të t’inkurajuar që të ikësh nga parcelat apo magazinat e kanabisit e të nisësh një jetë të re...”, përfundon autori.

**-Çapajev Gjokutaj** (Tetor 2016 “Panorama”) te “Të tymosësh retorikë” shkruan se njëra palë thotë se Shqipëria është bërë Kolumbi dhe e mbjellë me kanabis cep më cep nga jugu në veri dhe shton: “Ku të kam, o Lazarat!” duke theksuar se pala tjetër thotë se është shpifje dhe se sipas kësaj pale në qeverisjen e palës tjetër kultivohej shumë më tepër kanabis se sot dhe raportohej e kapej shumë më pak nga policia. Çështja e kanabisit është përmendur tangent por “tymosja” është përdorur në titull, duke dëshmuar jo vetëm fenomenin por edhe se sa afër shoqërisë shqiptare është një term i tillë.

**-Preç Zogaj** (Tetor 2016 “Panorama”) te “Shifrat për drogën ose karnavali u mbuluar me vergonja” kritikon shifrat e dhëna nga Edi Rama dhe Saimir Tahiri për asgjësimin e kanabisit ku shkruan se ata kanë komunikuar që kanë asgjësuar gjatë 2015-ës 99.6% të sipërfaqes së mbjellë me kanabis. “Vitin e kaluar policia e ka patur disi më të lehtë sepse sipërfaqja e kultivuar me drogë ka qenë 47.7 ha. Këtë vit sipërfaqja është pesëfishuar, është bërë 213.4 ha”, shkruan Zogaj. “Janë asgjësuar sipas drejtorit të Policisë së Shtetit 2.406.206 bimë. Operacionit i kanë shpëtuar vetëm nja dy mijë e 400 rrënjë të shkreta...shifra që paraqet qeveria nuk dalin, nuk rakordojnë”. Sipas Zogajt, 4-5 vitet e fundit (ky opinion është shkruar në 2016-ën) policia dhe mediat italiane, shqiptare dhe greke kanë raportuar pothuajse çdo ditë për kapje të konsiderueshme droge me origjinë nga Shqipëria ose brenda në Shqipëri. “734 kilogramë në Salerno, 277 kilogramë në Leçe, 324 kilogramë në Vlorë...mbi 1.5 tonë nga një llogaritje e thjeshtë...në muajt gusht dhe shtator do të shohim se sasinë e kapura dhe të raportuara kalojnë mbi 20 tonë.” Autori vlerëson saktësinë e të dhënave të “Guardia di Finanza”-s.

**-Roland Qafoku** (Tetor 2016 “Panorama”) te “Tri vitet e Qeverisë “Rama”” thekson se masiviteti i kultivimit të kanabisit është kthyer në një fenomen që cënon rëndë sigurinë kombëtare por sipas tij nuk është vetëm faji i policies sepse ka ardhur edhe për shkak të varfërisë, papunësisë, mungesës së arsimimit. Kanabisi përmendet si një nga dhjetra problematika të qeverisjes.

**-Ndue Dedaj** (Tetor 2016 “Panorama”) te “Plaçkitja e maleve dhe “mali” që nuk bëzan” shkruan se kryefjala e ditës është kanabisi, edhe në malësi. Dedaj flet edhe për një moment kur në Mat, sipas tij rojet e kanabisit i zënë rrugën prokurorit të shtetit. “Droga me shpejtësinë e erës po shndërrohet në industri...”, shkruan ai. Dedaj ngre problemin e shkretimit të malësive shqiptare. “Korrupsioni, krimi dhe kanabisi janë tre K-të e forta të kësaj kohe, teksa shteti është ai “mali” migjenian që nuk bëzan, nuk vepron energjitisht për të ndalur katastrofën, apo edhe më keq, mbyll njërin sy e njërin vesh kur myshterijë e shtetarëve ndërtojnë në mënyrë të kundraligjshme.”

**-Edmond Tupja** (Tetor 2016 “Panorama”) te “Opiumi dhe feja” thotë se tashmë “Droga është feja e shqiptarit” dhe se shqiptari ka nevojë për këtë fe. “Sot, droga, sidomos në formë hashashi, marijuane apo kanabisi, megjithë përpjekjet e qeverive të njëpasnjëshme shqiptare që nga viti 1991 për ta luftuar atë, është bërë tashmë tejet e njohur, masive, popullore dhe kultivimi i saj, për fat të keq i papërmbajtshëm”, mendon Tupja. Po ku është shkaku sipas tij? Cila është arsyeja? “...sa më dëshpërimisht përpiqet qeveria ta shtrijë këtë luftë në të gjitha zonat ku kultivohet kanabis sativa, aq më e qartë bëhet se mundësitë për ta fituar atë po zvogëlohen gjithashtu dëshpërimisht, sepse me sa duket me gjithë përfshirjen serioze të ndërkombëtarëve në këtë luftë, Karteli Shqiptar i

Drogës...e ka kuptuar dashurinë e madhe të popullit shqiptar për Lejdi Drogën...” thekson Tupja. Sipas tij nuk do të jetë e largët dita kur qeveria ta legalizojë.

**-Luçiano Boçi** (Tetor 2016 “Panorama”) te “Trapi i qeverisë” shkruan: “Herë pas here aty pranë i kalojnë ca skafe mbushur plot me gjethen çudibërëse, të cilave me buzëqeshje të sinqertë Rama i falet, i tund dorën e i merr haraçin.”

**-Kastriot Islami** (Tetor 2016 “Panorama”) te “Mafia Shqiptare = Korrupsion + Krim + Kanabis” e nis duke shkruar se Shqipëria konsiderohet si një nga vendet më të korruptuara dhe më të varfëra në Europë dhe se ka largime masive. “RILINDJA, NJË QEVERISJE, KLIENTELISTE, E KORRUPTUAR, KRIMINALE, KANABISTE...RILINDJA, NJË REGJIM NË SHKËRMOQJE QË KËRKON ZGJIDHJEN TE KANABISI”, shkruan Islami duke renditur si një nga arsyet e konstatimit të fundit edhe organizimin dhe kultivimin masiv e kapilar të kanabisit me mbështetjen e rrjetit të policisë. Islami flet edhe për “republikën” e vogël të kanabisit. Autori mendon se Rama do t’u vendosë në dispozicion mekanizmin e kultivimit të kanabisit si një mekanizëm elektoral për fitimin e zgjedhjeve duke mbjellëkështu farën e mafies së vërtetë. “KULTIVIMI I KANABISIT PO FAVORIZON KRIJIMIN E MAFIES...Kultivimi i kanabisit i ka dhënë të gjithë këtij kontigjenti mundësinë e kapjes së “juridiksionit territorial” përveç “juridiksionit lëndor”, të cilën e zotërojnë prej kohësh. E thënë më thjeshtë me zotërimin e “juridiksionit territorial”. Rama po u krijon të gjitha kushtet që në Shqipëri ata të organizohen si mafie e vërtetë. Ata po presin zgjedhjet e ardhshme që ky projekt i tyrë të marrë jetë. Dhe nëse s’do të ketë kundërveprim qytetar a veprim ndërkombëtar kjo është një ngjarje e sigurt. Rama po u jep mundësi të plotësojnë “ekuacionin”: Mafia=Korrupsion+Krim+Kanabis”, shkruan Islami.

## Viti 2017

**-Preç Zogaj** (Mars 2017 “Panorama”) te “Ku ishit ju, që lejuat kanabizimin e vendit?” (Në foto brenda artikullit Saimir Tahiri dhe Edi Rama) shkruan se Rama dhe Tahiri kanë vendosur të ndalojnë mbjelljen e kanabisit për këtë vit sepse superprodhimi i mëparshëm ka mbetur stok dhe për arsye të tjera. Zogaj u kërkon llogari se ku ishin kur kultivimi i kanabisit u përhap si epidemi në të katërt anët e vendit. Autori konstaton se bosët e drogës kontraktin njerëz për punë të kanabisit, ndërsa sipas tij Rama dhe Tahiri bënin propagandë. Ai citon ekspertët se sasia drogës ka shkuar rreth 450 tonë. “Kanabizimi i vendit, identifikimi i vendit me hashashin është një histori krimi, është një përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Edi Ramës dhe qeverisë së tij. Fatura është ajo që po i kërkon opozita me protestën e saj të pandalshme: të largohet për t’i hapur rrugën një qeverie të zgjedhjeve të lira e të barabarta. Droga është njëra prej dy arsyeve të jashtëzakonshme për këtë kërkesë të pazakonshme”, mendon Zogaj.

**- Mentor Nazarko** (Mars 2017 “Panorama”) te “Ministra ikin? Ah sa mirë! Ah sa keq!” (Në foto në artikull Saimir Tahiri dhe Edi Rama) flet për ndryshimet e ministrave në qeveri, ku fokusi mbetet sidomos te Tahiri.

**-Mark Marku** (Mars 2017 “Panorama”) te “Çadra që tronditi kupolën” ku trajton arsyet e shkarkimit të 4 ministrave Tahiri, Ilir Beqaj, Bledi Çuçi dhe Blendi Klosi shkruan se Saimir Tahiri



është akuzuar si përgjegjës për kanabizimin e Shqipërisë. “...presioni i tyre ndaj dukurisë së kanabizimit ishte fare i dobët”, shkruan Marku për ndërkombëtarët duke i atribuar vetëm, protestës të opozitës në çadër, shkarkimet e ministrave nga Rama. “Madje disa prej tyre në disa prononcime publike e anashkalonin këtë problem ndërsa të tjerë e relativizonin”, vazhdon Marku për ndërkombëtarët. “Ilir Meta përmes ministrave dhe deputetëve të tij po para katër javësh tentoi t’ibënte presion Ramës për Tahirin duke e akuzuar drejtpërdrejtë Ministrinë e Rendit si të shkrirë me narkotrafikun por në vend që të shkarkohej Tahiri u shkarkua ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, akuzuesi kryesor i ministrit Tahiri”, thekson Marku. Për autorin zgjedhjet e lira dhe republika e re janë zgjidhja.

**-Koço Kokëdhima** (Mars 2017 “Panorama”) te “Arnimet e qeverisë nuk janë zgjidhje” thekson se Saimir Tahiri ishte një ministër i përlyer në inkriminimin e Policisë së Shtetit në kanabizimin e vendit dhe në pasojat që do të ketë krimi i lidhur me këtë trafik, në zgjedhjet e ardhshme. Zgjidhja sipas Kokëdhimës duhet të jetë heqja e të gjithë zyrtarëve të policisë në qarqet e vendit të evidentuar si të lidhur me mafien e kanabisit dhe që marrin 20-30% të vlerës së prodhimit të drogës. Mafia e drogës sipas autorit ka sot fuqi financiare sa mund ndikojë zgjedhjet, parlamentin, qeverinë, mediat, drejtësinë milionat e drogës do të përdoren për të blerë vota, sipas tij. Është detyra e qeverisë që të garantojë militantët dhe qytetarët se një proces i lirë dhe i ndershëm zgjedhor do të bëhet realitet, mendon Kokëdhima si zgjidhje.

**-Fatos Lubonja** (Mars 2017 “Panorama”) te “Pse lëvizi Tahiri” (Nëfoto në artikull Saimir Tahiri dhe Edi Rama) shkruan se nuk ishte vetëm “efekti çadra” si faktor në lëvizjen e ministrit por edhe të tjerë. Ai merr në shqyrtim faktorin Ilir Meta, ndërkombëtarët, dobësinë e Ramës dhe arsyen e shkarkimit për shkak të konfliktit të brendshëm midis bandave dhe banditëve që mbështesin PS-së. “...ajo që opozita e quan “republika e kanabisit” apo e “krimit” në krye të së cilës është dora vetë Kryeministri, është një realitet që duhet marrë seriozisht.”, shkruan për efektin e ndërkombëtarëve Lubonja. “Shumë shpejt do të jemi në krizë”, paralajmëron Lubonja.

**-Pëllumb Nako** (Mars 2017 “Panorama”) te “Ku është plani i ri kombëtar antikanabis?” shtron nevojën e zbatimit të planit që do të zgjidhë problematikën. Në 3 mars të 2017-ës u bë prezantimi i planit me prezencë të kryeministrit, ministrit dhe Policisë së Shtetit, shkruan autori. Nako thotë se pati një kapërcim katastrofik të kultivimit të kanabisit nga 2015-ta në 2016 dhe plani duhet të gjente shkaqet. Sipas autorit alarmi për fenomenin është dhënë nga përhapja e teknologjisë dhe mediat sociale dhe për këtë arsye nuk mund të ketë censurë.

**-Mentor Nazarko** (Mars 2017 “Panorama”) te “Pse droga nuk blen dot zgjedhjet!” (Në foto te artikulli policë duke djegur kanabis) merr në shqyrtim nëse fuqia e madhe ekonomike që ka prodhuar droga do të mund të blejë zgjedhjet. Nazarko nuk mendon se mund t’i blejë. Nuk e quan Kolumbi e Europës dhe shkruan se problemi i drogës është global, njësoj si në Meksikë. Autori përmend drogën e mbjellë në Dibër, ku shprehet se paratë e saj nuk i blenë dot zgjedhjet aty, njësoj si paratë e drogës së Lazaratit nuk i blenë zgjedhjet e Gjirokastrës në qeverinë Berisha. Përgjegjësitë sipas tij për situatën duhen kërkuar edhe te opozita, jo vetëm te qeveria. “PSE NUK U VAZHDOJA BETEJA E LAZARATIT?”, pyet Nazarko, duke thënë se kur u godit Lazarati,

kështjella e drogës shqiptare sipas tij, u krijua një momentum i jashtëzakonshëm. “Momenti ishte për të ofruar një model të ri pune, jete për bujqësinë, popullin e Lazaratit dhe gjithë Shqipërinë. Për ta bërë këtë, megjithatë nuk mjaftonte vetëm qeveria. Duhej angazhim i faktorit ndërkombëtar, i cili vuante prej Lazaratit që helmonte rininë shqiptare”, mendon ai. Autori propozon që në vend që ndërkombëtarët të harxhonin para për ndjekje gomonesh, t’i investonin ato në bujqësi në Shqipëri, në artizanat, industri përpunuese dhe agroturizëm. “Për Lazaratin duheshin propozuar politika zhvillimore. Për bujqësinë e Shqipërisë duheshin propozuar gjithashtu politika të tilla. Dhe për këto politika do të duheshin programe, financime, të cilat do të duhet të vinin nga Perëndimi, normalisht”, thekson Nazarko.

- **Preç Zogaj dhe Inxh. Xhevahir Ngjeqari** (Mars 2017 “Panorama”) te “Kanabizimi eliminohet me projekte zhvillimi” shkruajnë se kanabizimi luftohet duke kombinuar veprimin e ligjit me politika dhe projekte të vërteta zhvillimi që prodhojnë punë, punësim dhe të ardhura dinjitoze. Sipas tyre kanabisi mund të frenohet nga presioni i opozitës dhe ndërkombëtarëve.

-**Pëllumb Nako** (Mars 2017 “Panorama”) te “Mungesë transparence apo implikim i Policisë?” flet ndër të tjera edhe për një operacion të zbulimit të një kamioni në shkurt 2014 me 8 tonë kanabis në Itali, ku sjell versionin Italian, i cili thotë se policia shqiptare nuk është përfshirë në operacion. Nako trajton problemin e sjelljes së Policisë së Shtetit në operacione, e cila në komunikime publike shfaqet e dyzuar duke mos folur në emër të sekretit hetimor, ndërsa italianët nga ana tjetër mohojnë pjesëmarrjen e saj.

- **Fatos Lubonja** (Tetor 2017 “Panorama”) te “Bombat lotsjellëse të Lu-së” kritikon qëndrimet e ish-ambasadorit amerikan Donald Lu që duhet të kishte ndonjë dokument që flet për lidhjet e kryeministrit me trafikantët, paratë e drogës, kryebashkiakët trafikantë. “Me një fjalë: a mund të mendohet se ambasadori nuk e di këtë gjendje që në anglisht e quajnë “state captured” (shtet i kapur”. Personalisht nuk e besoj këtë.”, shkruan Lubonja. Ai e mbyll me këtë zgjidhje: “Prandaj ngulmoj se në vend të shpresës te bombat e ambasadorëve, që shpesh na dalin lotsjellëse, është më mirë t’i ndërtojmë shpresat mbështetur në atë thënien tonë të urtë: “I zoti e nxjerr gomarin nga balta”.

- **Fatos Lubonja** (Tetor 2017 “Panorama”) (Në Foto Saimir Tahiri) te “Krimi ndjell krimin” flet për implikimin e dyshuar të ish-ministrit të Punëve të Brendshme Saimir Tahiri, të cilin e identifikon si skandali Habilaj-Tahiri&Co, njësoj si disa komente të tjera gjatë këtij muaji të 2017-ës në gazetën Panorama. “Që ministri ynë i Brendshëm, Saimir Tahiri, sipas përgjimeve të Prokurorisë Italiane, ka marrë 30 000 euro për çdo rrugë nga trafikantët e drogës dhe makina e tij është përdorur për trafikim droge, është një provë këlthitëse e kësaj.”, shkruan Lubonja.

Seria e këtyre shkrimeve mbi përgjimet, akuzat, heqjen e imunitetit dhe mandatit si deputet dhe arrestimin e Tahirit vazhdon në 5 raste të tjera nga opinionistë si: Agron Gjekmarkaj<sup>14</sup>, Fitim Zekthi, Mark Marku, Romeo Gurakuqi, Qemal Lame ku në qendër janë edhe fotot e Tahirit dhe

---

<sup>14</sup> Të gjitha opinionet, redaksionale, komentet dhe analizat që janë analizuar në këtë pjesë të studimit gjenden të plota te Shtojcat.

Ramës. Këto shkrime vënë në shënjestër përveç Tahirit edhe Edi Ramën. Analizat ngrihen edhe në nivel politik.

- **Mark Marku** (Tetor 2017 “Panorama”) te “Të vërtetën e Tahirit gjejeni te Edi Rama” konstaton se që prej një viti gjithë Shqipëria është mbushur me kanabis dhe se u mundësua nga bashkëpunimi i kultuesve me Policinë e Shtetit, duke shkuar nga shefat e vegjël të Tahiri dhe te i madhi fare, Edi Rama. Marku mendon se Rama po bën kokë turku Tahirin duke bërë sikur nuk ka ditur gjë pas përgjimeve që kompromentonin rëndë Tahirin. “...e vetmja e vërtetë që mbetet për t’u zbuluar para shqiptarëve nga ngjarjet që do të pasojnë është kjo: e kontrollon Rama krimin e organizuar apo krimi i organizuar Ramën? Të tjerat dihen!”, përfundon Marku.

-**Agron Gjekmarkaj** (Tetor 2017 “Panorama”) Mendon se kultivimi i drogës në gjithë territorin shqiptar është bërë nën sehirin e policisë, në bashkëpunim dhe përfitim, ku u ndërtuan pista, u rrëzuan avionë, u transportua me skafe dhe kamionë duke e bërë Shqipërinë Kolumbinë e Europës. Rama dhe Tahiri sipas tij gjatë kësaj kohe kanë mohuar gjithçka, teksa Rama e quante Tahirin ministrin më të suksesshëm edhe pse opozita e ka akuzuar si protektor të trafikut, sipas tij. Gjekmarkaj mendon se Rama ka patur mundësi të informohet nga Shërbimi Informativ, ndërkombëtarët, miqtë e tij, mediat dhe opozita edhe nëse Tahiri ia ka fshehur.

-**Lavdrim Lita** (Tetor 2017 “Panorama”) te “Nevoja për një kod Antimafia” shkruan se përgjimet italiane të Habilajve dëshmojnë për një implikim të mundshëm të shumë institucioneve të shtetit (Policia e Shtetit, QNOD etj) në aktivitete kriminale”. Zgjidhja? Miratimi i një kodi Antimafia dhe krijimi i një Autoriteti Kombëtar Antimafia që të lëshojë certifikatë antimafia.

-**Tomor Alizoti** (Tetor 2017 “Panorama”) te “A është Rama përgjegjësi kryesor për drogën?” tregon se Shqipëria është kthyer në qendër të lajmeve për trafik ndërkombëtar droge. Sipas tij në qendër të tyre është Tahiri që dyshohet se ka qenë pjesë e rrjeteve të trafikut madje mbështetësi dhe ideuesi i një rrjeti të madh. Trafiku i drogës, sipas Alizotit funksionon për shkak të lidhjes krim-politikë. Shqipëria sipas tij ka pozitë gjeografike dhe infrastrukturë si pistat e avionëve, gjë që favorizon këtë tragjik. “...duket se Tahiri ka qenë nga ata politikanë në majë të vendimarrjes.”, thekson Alizoti duke shtuar se: “Studiuesit thonë se kur ky trafik vazhdon gjatë...e përfshirë është qeveria...”. Sipas tij kur qeveria përndjek oficerë si Dritan Zagani që denoncojnë trafiket, atëherë maja e qeverisë është në shërbim të trafikut. “Kryeministri...ka qenë mbrojtësi më i madh i Tahirit”, thekson autori duke shtuar më tej se ky trafik nuk mund të bëhej nëse nuk do donte Rama. Zgjidhja? Duhet të jemi të gjithë kundër Ramës.

-**Preç Zogaj** (Tetor 2017 “Panorama”) te “Do luftojë SHBA bandat në Shqipëri! Po Rama pse duhet në Qeveri?” (Në Foto Edi Rama) thekson se goditja e trafikut të drogës ka ardhur nga partnerët ndërkombëtarë. Rama sipas tij duhet të japë dorëheqjen.

## Viti 2018

-Në vitin 2018 evidentohen një fluks më i lartë opinionesh krahasuar me periudha të tjera. Gjatëkësaj kohe, në dy muajt e zgjedhur, mars dhe tetor, konstatohet një prirje e analistëve për t’u

marrë me çështje specifike si rasti i kapjes së kokainës në Portin e Durrësit në sasinë e 613 kilogramëve dhe Arbër Çekaj, çështja Babale<sup>15</sup>, zëvendësimi i Xhafajt me Lleshin që për disa opinionistë shihet si zgjidhje e situatës së mbulimit me kanabis meqë është më shumë burokrat se i përfshirë politikisht, çështja e ish-oficerit të policisë Dritan Zagani, operacione të policisë etj. Pra, nga prirja për të analizuar përhapjen në të gjithë vendin të mbjelljes së kanabisit në vitet 2016-2017 si dhe të skandaleve të mëdha si ai i Tahirit, kalojmë më shumë te prirja e analizës së skandaleve specifike por me impakt të madh.

Një pjesë e opinioneve gjatë muajit tetor janë politike dhe vënë në qendër të analizës kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama. Trajtimi i çështjeve është sa në nivel informativ dhe teknik po ashtu edhe në nivel politik. Nga këto opinione mund të veçojmë:

- **Ilir Demalia** (Mars 2018 “Panorama”) te “Konteneri që po i merr të gjithë përpara” shkruan se Shqipëria ka qenë pjesë e trafikeve të drogës gjatë gjithë tranzicionit. Sipas tij droga mori zhvillim gjatë mandatit të parë të Ramës sepse ishte i vetmi burim për të qarkulluar ekonominë ndërsa gjatë mandatit të dytë i doli fare boja me rastin Tahiri, ku normalisht sipas autorit duhet të kishte rënë fare si qeveri. Analiza e tij ngrihet në nivel politik. “Konteneri” duhet ndalur, mendon Demalia.

- **Nikollaq Neranxi** (Mars 2018 “Panorama”) te “Në një republikë bananesh si e jona, mbijetojnë vetëm importuesit e tyre” flet për kontrastin mes trafikimit të 613 kilogramëve kokainë dhe biznesit të ndershëm. “...biznese milionere që mbijnë nga hiçi? Për çfarë reforme në drejtësi po flasim, ndërkohë që paraja e drogës ka blerë tashmë çdo gjë dhe gjithçka po ndodh sheshit, pasi ato po investohen para syve tanë?”, pyet Neranxi, duke shtuar se të gjithë jemi peng të kriminelëve. Autori mendon se qeveria u detyrua të lëvizë qëkur bënë presion ndërkombëtarët. Zgjidhja? Largimi i Ramës dhe riformatimi i një qeverie të re, qoftë edhe teknike.

- **Edmond Tupja** (Mars 2018 “Panorama”) te “Marijuanisht e kokainisht” trajton ngjarjen e kapjes së 613 kilogramëve kokainë në Portin e Durrësit duke thënë se vlera e saj është 180 milionë euro. Ironia është e thekshme, në vazhdim të shkrimit të tetorit 2016.

- **Pëllumb Nako** (Mars 2018 “Panorama”) te “Dy operacione policore dhe dy qëndrime” merret me ngjarjen e kapjes së 613 kilogramëve drogë dhe tënjë operacioni tjetër të Policisë së Shtetit për arrestimin e 39 personave, që policia i dyshon si pjesëmarrës në 7 grupe kriminale. Nako analizon komunikimet publike të policisë për këto dy aksione që sipas tij kanë lënë shtigje për interpretim duke e mjegulluar procesin. Autori mendon se mund të ketë patur prishje të aksionit me dalje informacionesh në rastin e 613 kilogramëve kokainë dhe për këtë duhej bërë publik vetëm pasi të përfundonte (me arrestimin mbase të autorëve të dyshuar) dhe jo të dekonspirohej.

## Viti 2019

-Në vitin 2019 në gazetën “Panorama” shenjohej një ulje e fluksit të opinioneve, ku konstatohen 2 në mars dhe 4 në tetor.

---

<sup>15</sup> Ku pretendohet se vëllai i ish-ministrit Fatmir Xhafaj kishte bërë trafik droge.

**-Romeo Gurakuqi** (Mars 2019 “Panorama”) bën një shikim të përgjithshëm të situatës problematike të Shqipërisë të “Ora e ndalun e Shqipërisë” ku justifikon edhe largimin e opozitës nga parlamenti.

**-Desada Metaj** (Mars 2019 “Panorama”) të “Dosja 339” fundi i makthit të Ramës” shkruan mbi përgjimet e kësaj dosjeje, personazhet e së cilës sipas saj ishin objekt i një vendi anëtar të BE-së. Autorja mendon se duhet zbardhur plotësisht dosja dhe duhet vënë drejtësi me qëllim që të ketë një process normal elektoral në Shqipëri.

**-Pëllumb Nako** (Tetor 2019 “Panorama”) të “Trafiku ndërkombëtar i drogës dhe përgënjeshtimet e policisë” merr në shqyrtim raportin polici-media-publik, ku sipas tij policia duhet ta bëjë pjesë të çështjes median dhe publikun. Autori konstaton deklarime të pavërteta të Policisë së Shtetit sepse perceptimi dhe ndjeshmëria e opinionit publik përcakton suksesin e kësaj policie, jo aq faktet dhe rezultatet e punës. Duhet transparencë, thotë autori. Policia sipas tij jo vetëm nuk parandalon trafikimin e lëndëve narkotike por edhe i përgënjeshton kur bëhen të pranishme nga mediat ndërkombëtare.

**-Genc Pollo** (Tetor 2019 “Panorama”) të “Tetë pyetje për zotin Sandër Lleshaj” nga tetë pyetje, 7 i ka lidhur me problematikën e kanabisit. Pyetjet sjellin përmbledhtaz disa nga shqetësimet e hershme të opinionistëve. “1- kur u mor vesh se avionë të vegjël transportonin drogë nga Shqipëria në Itali duke përdorur aeroporte ushtarake si Gjadri apo edhe aerodrome e pista rrethore; 2- kur u bë e qartë se mohimi nga Ministria e Mbrojtjes i përdorimit të aeroporteve nga avionët e drogës rezultoi i pavërtetë; 3-kur shefi i Shtabit të Përgjithshëm Bazo në maj 2014 pretendoi publikisht se është i pamundur transporti i drogës me avion “meqë hapësirën ajrore të Shqipërisë e monitoron NATO”, çka ishte tërësisht e gënjeshtërt, pasi NATO nuk ka objekt aviacionin civil e aq më pak aeroplanët privatë; 4- kur debatohej në publik se mbjellja masive e drogës në vendin tonë në vitin 2016 përbënte rrezik për sigurinë publike e kombëtare; 5-kur raportet e Europolit, Departamentit të Shtetit të ShBA-ve, Zyrës për Drogën e Krimin të OKB (UNODC) dhanë alarmin pas vitit 2016 për kanabizimin e vendit e pasojat e rrezikshme të tij; 6-kur rezultoi se bandat e narkotrafikantëve kontrollonin radarët e bregdetit dhe i fiknin ata sa herë u nevojitej atyre për fshehur transportet e drogës; 7-kur një ministër i qeverisë Rama sugjeroi ndërhyrjen antidrogë të Ushtrisë, pasi Policia konsiderohej e kanabizuar...”, shkruan Pollo.

## **Viti 2020**

-Dy redaksionalet e “A1 Report” konstatojnë fenomenin e kanabizimit të Lazaratit të “Lazarati turistik, guida e munguar” dhe “Emergjencia Kombëtare: Delazaratizimi i PD-së”. Te “Lazarati turistik...” jepet ideja që Lazarati të vendoset si destinacion turistik sepse është fjala me e klikuar në 2014-ën.

**-Agron Gjekmarkaj** (Janar 2020 “Balkanweb.com”)konstaton kanabizimin e vendit dhe heshtjen e ish-ambasadorit amerikan Donald Lu për problematikën.“Në fakt, paraardhësi juaj i nderuar, Donald Lu, që mësoi edhe shqip mjaft mirë, nuk tha asnjë fjalë për ta dënuar projektin më të madh politik të “Rilindjes” kanabizimin e vendit. U tund e trand media botërore, por ai heshti

mestoicizëm. Dilemë e madhe zu fill. Në shumicën e rasteve, për çdo gjë që shkonte keq, ai ndëshkonte opozitën me deklarata e qëndrime. Jo pak vetave u është mbushur mendja që Edi Rama, për çdo gjë që bën e që ndodh këtu, ka bekimin e vendit të madh mik. Por çfarë ndodh me të vërtetë këtu?! Me modesti po përpiqem t'ju ofroj legjendën, për të lexuar nga këndvështrimi subjektiv i një qytetari, pikërisht vendin në të cilin ju priteni me shpresë të madhe. Ëndërrimtarët besojnë se me “kamxhik” në dorë ju do të “frustoni” trazovaçët e politikës shqiptare dhe do ta fusni në binarë demokracinë e shkërmoqur, por hiri i së vërtetës na e kërkon të themi se ata janë gjithnjë e më të paktë. Paçka se në kafenetë tona të panumërta besojmë se jemi kërthizë e botës, në fakt, jemi vetëm një vend i vogël ku zihemi si dreqër me njëri-tjetrin. “Gjyqet” tona i bëjmë tek ambasada juaj.”

**-Hamdi Jupe** (Janar 2020, “Panorama”) parashikon implikimin e deputetëve të ardhshëm me krime të drogës si dhe **Enton Palushi** (Janar 2020, “Panorama”) gërshetimin e drogës me manipulimin e zgjedhjeve.

**- Pëllumb Nako** (Janar 2020, “Panorama”) te “Financat e Organizatave Kriminale” konstaton praninë e drogës në Shqipëri. “Të gjithë skenarët janë zhvilluar nën emëruesin e përbashkët të mirënjohur për vendin tonë, ajo e prishjes së pazareve të drogës.”, shkruan duke shkruar më tej: “Të gjithë skenarët janë zhvilluar nën emëruesin e përbashkët të mirënjohur për vendin tonë, ajo e prishjes së pazareve të drogës. Nuk munguan as drejtuesit e lartë të Policisë, që u zhvendosën drejt vendit të ngjarjes. Në gjithë rreshtat e mësipërm të përmbledhur nga njoftimet mediatike, ashtu si dhjetëra të tillë në raste të mëparshme, shfaqen qartë disa nga tiparet më të qenësishme të grupeve kriminale me stampë shqiptare, njëlloj si nevoja urgjente e organeve tona...Aktiviteti i tyre në trafikun e drogës përfshinte drogë ende të prodhimit, të tranzitit dhe të destinacionit. Mjafton kaq për të konkluduar se globalizimi i krimit tashmë është kthyer në realitet të kapshëm. Një konflikt, i cili fillon diku në Belgjikë, që vazhdon me një vrasje në Itali dhe që pasohet nga një tjetër në Rrëshen, pa futur këtu raste e tjera, flet pastër për gjeografinë e tij. Ndaj, edhe hetimi i një aktiviteti kriminal me shtrirje të gjerë në vende europiane, me konflikte të mbarsura në këto vende dhe të vazhduara me larje hesapësh në to e më pas në Shqipëri, mbetet një mision super i vështirë për organet tona.”

## 7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Studimi u përgjigjet katër pyetjeve themelore të vendosura si qëllim dhe pyetjeve të tjera kërkimore në funksion të tyre, duke treguar se cilat janë sjelljet popullore rreth kultivimit të kanabisit në Shqipëria kanë ndryshuar opinionet në kohë, cilat lloj zgjidhjesh propozohen dhe cili është roli i shoqërisë civile.

-Raportimi mbi kanabisin dhe drogat e tjera është i pranishëm në mediat në Shqipëri në 10 vitet e fundit. Raportimi mediatik mbi kanabisin lidhet me sasitë e asgjësuar të kanabisit të komunikuar nga Policia e Shtetit apo institucione të tjera duke qenë se është komunikuar asgjësim. Ndodh që rritja e numrit të rrënjëve të asgjësuar të lidhet me rritjen e fluksit të raportimeve të zakonshme dhe opinioneve, speciale etj, ashtu si ka edhe momente kur kjo prirje lëkundet. Numri më i lartë i

asgjësimit ka ndodhur në vitin 2016, (duke llogaritur që bëhet fjalë për shifrat e vetëm 3 muajve e gjysmë) dhe më i ulëti në 1997-ën. Një nga pikat kulmore edhe për raportimin është tetori i vitit 2016. Kemi rritje të ngjashme nga 2015-ta në 2016-ën në numrin e bimëve të sekuestruara të kanabisit dhe numrin e lajmeve për këto problematika në gazetën “Panorama”. Kemi kontrast të rëndësishëm mes formës së grafikut nga 2016-ta deri në 2019-ën. Nga 2016 deri në 2018-ën kemi ulje të asgjësimit të kanabisit në Shqipëri, ndërsa kemi rritje të raportimit të lajmeve mbi kanabisin dhe drogat. E kundërt është forma e grafikut edhe nga 2018-ta në 2019-ën. Në këtë periudhë rritet numri i bimëve të asgjësuar por ulet numri i lajmeve. Arsyet sërish mund të hamendësohen se kanë të bëjnë me mungesën e saktë të statistikave për asgjësimet, me mungesën e komunikatave të Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera për aksionet, me humbjen e interesit të gazetës për çështjen, me mungesën e interesit të opinionit publik gjë që influencon edhe interesin e gazetës etj.

-Gjatë periudhave të monitoruara gjenden raportime mbi kultivimin e kanabisit në disa zona në Shqipëri, nga jugu në veri dhe nga lindja në perëndim. Harta me kalimin e viteve sa vjen dhe zgjerohet.

-Gjatë periudhave të monitoruara gjenden raportime që në fokus kanë çështje ku përmenden emra të qeverisë, kryeministri Edi Rama, ish-ministrat e Punëve të Brendshme Saimir Tahiri dhe Fatmir Xhafaj.

-Gjatë periudhave të monitoruara gjenden në medie redaksionale, opinione, komente dhe analiza të thelluara të lidhura kryesisht me kanabisin.

-Nuk gjenden gjurmë të zgjidhjeve që ofron shoqëria civile (organizatat jofitimprurëse) në Shqipëri për eliminimin e fenomenit.

-Numri i artikujve të ekspozuar në faqen e parë konstatohet se vjen në trend rritës, nga 2009-ta në 2020-ën. Kjo tregon se për gazetën “Panorama” tematika e kanabisit dhe drogave të tjera sa vjen dhe bëhet edhe më e rëndësishme.

-Kryesisht në formën e opinioneve, në 10 vitet e fundit, ndeshim kulminacion të tyre në vitet 2017-2018. Grafiku tregon se kemi një riaktivizim të tyre gjatë muajit janar të këtij viti. Priorja më e rëndësishme për t’u lexuar është mosekzistenca e tyre për tematikën e kanabisit dhe drogave të tjera që prej vitit 2009 deri në 2016-ën, duke përjashtuar vetëm një rast të konstatuar të një opinion në vitin 2010.

-Autorët përgjithësisht konstatojnë prezencën e kultivimit të kanabisit por po kështu bëjnë edhe një diferencim mes periudhash, sa i përket përkeqësimit të situatës. Autorë si dhe personazhe të përfshirë në politikë përcjellin po ashtu shqetësimin e përgjithshëm me të cilin ndeshet shoqëria shqiptare. Ata konstatojnë shkaqe, elementë që e favorizojnë përkeqësimin apo njerëz dhe personazhe që nxisin kultivimin e tij. Përpos tyre, opinionshkruesit japin edhe zgjidhje për reduktimin e fenomenit, duke e konstatuar si të tillë. Ato janë politike, ekonomike, sociale etj. si: dorëheqja e kryeministrit Edi Rama, ngritja e qeverisë së re qoftë edhe teknike, puna më e mirë e Prokurorisë për Krime të Rënda, shkarkimi i drejtuesve të policive në qarqe që dyshohen si të

përfshirë në trafik, investimi në zonat e kultivimit të kanabisit, lufta ndaj kanabisit duke kombinuar veprimin e ligjit me politika dhe projekte të vërteta zhvillimi që prodhojnë punë, punësim dhe të ardhura dinjitoze, frenimi i kultivimit të kanabisit me presion nga opozita dhe ndërkombëtarët, investimi i ndërkombëtare në bujqësi, në artizanat, në industrinë përpunuese dhe agroturizëm etj.

**Rekomandimi kryesor** pas këtij studimi të kushtëzuar nga koha dhe burimet është thellimi në frekuencat e raportimeve në medie të tjera si “Top Channel” për shembull. Por jo vetëm kaq, edhe mbi zbulimin se pse në situata kur kanabisi ka mbuluar gjithë vendin nuk kanë mbajtur qëndrime apo nuk i kanë kushtuar rëndësi.

Paraprakisht për studime të ardhshme mund të japim për shkak të njohjes së tematikës një ide të përgjithshme, e cila duhet vërtetuar me studime shkencore e profesionale. Në periudhën 2009 e 2013 çështja e drogës ka qenë jo shumë rrahur. Pas vitit 2012, “**Top Channel**”, “**A1 Report e Shqiptarja**” godasin vijimësisht Lazaratin duke qenë se pretendojnë se është i lidhur me zyrtarë të PD-së. Bëjnë speciale dhe raportime të thjeshta.

Pas 2013, me ardhjen në pushtet të PS-së, intensifikohet goditja e “**Top Channel**”, “**A1 e Shqiptarja**” ndaj Lazaratit ndërsa “**Balkanweb.com**” është më i ekuilibruar në raportim. Bën speciale kundër drogës por bën edhe raportime të thjeshta.

Pas rënies së Lazaratit dhe përhapjes së kanabisit në mbarë vendin, “**Top Channel**”, “**A1 e Shqiptarja**” bën raportime për drogën e kapur por i mëshojnë më shumë deklaratave zyrtare të policisë shqiptare e “Guardia di Finanza”-s, sipas të cilave sipërfaqja e mbjellë ishte në rënie ndërkohë që ishte krejt e kundërta. “**Balkanweb.com**” raporton duke shfrytëzuar “**News24**” si media mëmë me gazetarë kronike. Bën speciale në disa pjesë të vendit duke raportuar për drogën e mbjellë gjithandej por bën edhe raportime të thjeshta.

Mediat si “**Top Channel**” e “**A1 Report**” gjatë kanabizimit të Shqipërisë kryesisht nuk kanë qëndrime apo opinione kundër drogës. Ato publikojnë më së shumti qëndrime të politikanëve apo zyrtarëve të ndryshëm. “**Balkanweb.com**” është zë disi më i pavarur duke qenë se mbahet edhe me lajmet e “**News 24**”, ku ftohen elementë të opozitës apo personazhe kritikë si Fatos Lubonja etj. që ngrenë zërin kundër dukurisë.

Vitet e fundit, çështja e drogave të lehta ka rënie të lehtë për shkak të presionit ndërkombëtar sidomos gjerman dhe ka një rënie të sipërfaqeve të mbjella. Ka goditje e arrestime të herëpashershme policësh e kryepiqsh e përgjithësisht raportimet kanë qenë të thjeshta. Aksioni opozitar ka zbehur disi vëmendjen ndaj drogës ndërsa raportohen ulje të sasive të drogës të kapura në vendin fqinj vitin e fundit. Raportimet nga mediat tashmë kanë qenë të thjeshta pa u fokusuar te specialet apo te mbajtja e kësaj tematike për ditë me radhë, siç ndodhte në 2016- 2017 apo 2018.



## **8. BIBLIOGRAFIA**

1. Gazeta “Panorama”, 2009-2020
2. “Panorama.com.al”, 2009-2020
3. “Balkanweb.com”, 2015 dhe 2020
4. “A1 Report”, “Shqiptarja.com”, 2015 dhe 2020
5. Shqyrtim arkivash “Top Channel”, “News24”, Gazeta “Tema”, “Exit News” etj
6. Raportet e “Guardia di Finanza”
- 7.” Exit.al” 1. <https://exit.al/2017/11/raporti-i-gdf-se-2017-zbulohen-me-pak-plantacione-kanabisi-ne-shqiperi-por-kapet-me-shume-droge-shqiptare-ne-itali/>
8. Fjalim i ministrit Sandër Lleshaj në Kuvendin e Shqipërisë më 12 shkurt 2020

## 9.SHTOJCA

### 1.Tabela nr.1

<b>Numri i lajmeve me fjalëkyçe: Drogë, Kanabis, Marijuanë, Heroinë, Kokainë, Hashash, Vrasje dhe Drogë, Drogë dhe Politikë</b>			
<b>Media/Periudha</b>	<b>Numri Total i Lajmeve</b>	<b>Opinione/Komente/ Analiza</b>	<b>Zonat e përmendura</b>
A1 Report 1-31 janar 2020	85 drogë-13 politikë-3 speciale dhe 2 ekskluzive  40 kanabis (8 nga të cilat politikë)  0 marijuanë  12 heroinë (nga të cilat 0 politikë-1 speciale dhe 1 ekskluzive )  75 kokainë (nga të cilat 22 politikë-1 speciale, 1 ekskluzive )  11 hashash (nga të cilat 1 politikë-1 ekskluzive)  Total: 223	2 analiza Mero Baze  1 analizë redaksia-rasti Lefter Alla  Total: 3	Vlorë, Itali, Manastir, Greqi, Angli, Memaliaj, Has, Konispol, Holandë, Gjermani, Himarë-Livadh, Llezhtë, Mallakastër, Rrëshen, Shijak, Xibrakë, Elbasan, Lazarat, Tepelenë, Tiranë, Paskuqan, Korçë, Bilisht, Shkodër, Fier
Balkanëb 1-31 janar 2020	80 droge ( nga të cilat 13 politike-1 ekskluzive dhe 1 intervistë)  21 kanabis (nga të cilat 1 politikë-1 speciale)  10 marijuanë  13 heroinë (nga të cilat 2 politikë_ )  84 kokainë (rasti I kryebashkiakut të Bulqizës), (nga të cilat 39 politike- 2 ekskluzive)  7 hashash (nga të cilat 1 politikë)  Total: 215	1 Analizë-Agron Gjekmarkaj  Total: 1	Stuni Itali, Livorno, Mamurras, Durrës, Greqi, Karaibe-Greqi, Lazarat, Memaliaj, Tiranë, Brazil, Kufiri grek, Kostur, Rrëshen, Kamëz, Shqipëri-Holandë, Europë, Firenzë, Bolonja, Shkodër UK, Konispol
Panorama 1-31 janar 2020	42 drogë (nga të cilat 6 politikë-4 speciale)	1 opinion-Agron Gjekmarkaj	Itali, BE, UK, Bolonja, Londër, Kamëz, Tiranë,

	<p>11 kanabis (nga të cilat 7 politikë)</p> <p>1 marijuanë (nga të cilat 1 speciale)</p> <p>7 heroinë- (nga të cilat 1 speciale)</p> <p>45 kokainë (nga të cilat 14 politikë-2 speciale)</p> <p>Total: 106</p>	<p>1 opinion-Enton Palushi 1 opinion-Pëllumb Nako 1 opinion-Hamdi Jupe</p> <p>Total: 4</p>	<p>Shqipëri-Itali, Memaliaj, Greqi, Qafë-Botë, Brazil, Mirditë, Shijak</p>
A1 Report 1-30 qershor 2015	<p>28 Drogë (nga të cilat 6 politike- 1 speciale)</p> <p>45 kanabis (nga të cilat 4 politike-4 speciale)</p> <p>4 Marijuanë (nga të cilat 1 politikë-1 speciale)</p> <p>10 Heroinë</p> <p>13 Kokainë</p> <p>8 Hashash</p> <p>Total: 108</p>	<p>2 qëndrime redaksionale</p> <p>Total: 2</p>	<p>Lazarat, Korçë, Itali, UK, Fier, Xibrakë, Itali-Greqi, Genova, Kukës, Lushnje, Tiranë, Belgjikë, Krujë, Delvinë, Elbasan, Gjirokastër, Mallakastër, Vlorë, Kakavijë, Shkodër, Brindisi, Tepelenë, Gjirokastër, Berat, Lushnje, Greqi, Fushë-Krujë, Tropojë</p>
Balkanëeb 1-30 qershor 2015	<p>11 Drogë (nga të cilat 3 Politikë)</p> <p>3 Kanabis</p> <p>3 Marijuanë</p> <p>0 Heroinë</p> <p>7 Kokainë (nga të cilat 1 speciale)</p> <p>Total: 24</p>	<p>Nuk gjenden analiza.</p> <p>Total:0</p>	<p>Në përgjithësi pa zona specifike.</p>

**2.Tabela Nr.2**

<b>Numri i lajmeve me fjalëkyçe: Drogë, Kanabis, Marijuanë, Heroinë, Kokainë, Hashash, Vrasje dhe Drogë, Drogë dhe Politikë -Panorama 2019-2020</b>							
<b>Periudha</b>	<b>Numri Total i Lajmeve</b>	<b>Të ekspozuar në faqen e parë</b>	<b>Të ekspozuar në faqen e</b>	<b>Kryeartikull</b>	<b>Speciale</b>	<b>Opinione/ Komete</b>	<b>Zonat e përmendura</b>

	(Drogë, Kanabis, Marijuanë, Heroinë, Kokainë, Hashash, Vrasje dhe Drogë, Drogë dhe Politikë)		parë si lajm i dytë				
1-31 janar 2020	106	0	0	0	8	4 opinione: Agron Gjekmarkaj , Enton Palushi, Pëllumb Nako, Hamdi Jupe	Itali, BE, UK, Bolonja, Londër, Kamëz, Tiranë, Shqipëri-Itali, Memaliaj, Greqi, Qafë- Botë, Brazil, Mirditë, Shijak
1-31 Tetor 2019	69	10 (lajme dhe opinionë)	1 ( vrasje në Kavajë)	0	2	3 opinione: Pëllumb Nako, Agron Gjekmarkaj , Rigers Lenja	Greqi, Elbasan, Brazil, Vlorë, Kavajë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Skrapar, Tiranë, Astir, Fier, Vlorë, Lushje
1-31 Mars 2019	61	14 (lajme dhe opinionë)	1	0	0	2 opinione: Romeo Gurakuqi, Desada Metaj	Lezhë, Durrës, Tiranë, Shkodër, Korcë, Fier, Elbasan, Karaburun, Greqi, Kurbini, Lac
1-31 Tetor 2018	163	66 (lajme dhe opinionë)	9	0	0	19 opinionë: Agron Gjekmarkaj (2), Kiço Blushi, Pëllumb Nako (2), Alban Dudushi, Mark Marku, Çapajev Gjokutaj, Preç Zogaj, Fatos	Greqi, Fier, Vlorë, Kamzë, Tiranë, Gjermani, Has, Shkodër, Durrës, Shkozë, Karaburun

						Lubonja (2), Mentor Nazarko, Genc Pollo, Luçiano Boçi, Lavdrim Lita, Ergys Mërtiri, Fitim Zekthi, Ndue Dedaj	
1-31 Mars 2018	97	17	2	1	1	6 opinione: Agron Gjekmarkaj , Nikollaq Neranxi, Edmond Tupja, Ilir Demalia (2), Pëllumb Nako	Kolumbi, Lezhë, Itali, Greqi, Sarandë, Durrës, fshati Ninesh në Fratar të Fierit, Maminas, Kostur, Krujë, Gjirokastër, Korçë, Vlorë, Lazarat, Memaliaj, Elbasan, Spanjë, Gjermani, Lezhë
1-31 Tetor 2017	140	46	8	4	11	19 opinione: Fatos Lubonja (2), Lavdrim Lita (2), Mark Marku (2), Agron Gjekmarkaj (2), Elvis Zaimi, Prec ZOGaj (2), Tomor Alizoti, Hamdi Jupe, Dardan	Durrës, Itali, Tiranë, Laknas, Kufi me Malin e Zi, Sicili, Elbasan, Vlorë, Babiçë, Luzat, Rinas

						Mustafaj, Fitim Zekthi, Romeo Gurakuqi, Qemal Lame, Eduard Halimi, Pëllumb Nako	
1-31 Mars 2017	67	17	0	2	3	12 opinione: Prec Zogaj (2), Mentor Nazarko (2), Mark Marku, Koco Kokëdhima , Fatos Lubonja, Luciano Boci, Pëllumb Nako, Agron Gjekmarkaj , Romeo Gurakuqi, Pëllumb Nako	Karaburun, Autobusi Shkodër- Pistoja, Devoll- Korcë, Ankona, Gjirokastër, Sazan, Skrapar, Shkodër, Krujë, Lezhë, Vlorë, Fier, Kakavijë, Itali, Zvërnec, Krujë, Elbasan, Muriqan
1-31 Tetor 2016	119	24	1	0	12	9 opinione: Tritan Shehu, Gjergj Meta (2), Capajev Gjokutaj, Prec Zogaj, Roland Qafoku, Ndue, Dedaj, Edmond Tupja, Kastriot Islami	Mat, Ishëm, Kepi i Rodonit, Tiranë, Vlorë, Shkodër, Tepelenë, Durrës, Itali, Fier, Sarandë, Tragjas, Shëngjergj, Lalç, Krujë, Fag (afër Dajtit), Muriqan, Greqi, Gjirokastër, Fier, Igumenicë, Mallakastër,

							Kurbin, Mamurras, Dukagjin
1-31 Mars 2016	41	8	2	0	0	0 opinione	Farkë, Tiranë, Përmet, Kukës, Vlorë, Gjirokastër, Durrës, Kakavijë, Akërnë, Ish- Bllok, Fushë- Krujë, Korçë, Lezhë, Elbasan, Tepelenë, Berat, Kufi me Greqinë
1-31 Tetor 2013	24	3	0	0	1	0 opinione	Lazarat, Vlorë, Sarandë, Kakavijë, Bilisht, Kapshticë, Itali, Gjirokastër (droga nga Lazarati), Greqi, Durrës
1-31 Mars 2013	16	0	0	0	0	0 opinione	Durrës, Sarandë, Shkodër, Dibër, Korçë, Tiranë (Greqi- Shqipëri), Vlorë, Kakavijë, Elbasan, Lazarat, Igumenicë
1-31 Tetor 2012	27	2	0	0	1 (Lazarat)	0 opinione	Tiranë, Elbasan, Sarandë, Shkodër, Durrës, Itali Lazarat, Gjirokastër, Porti i Durrëst, Kakavijë, Hani i Hotit, Igumenicë, Belgjikë

1-31 Mars 2012	32	6	0	0	0	0 opinione	Gjirokastër, Durrës, Shkodër, Tiranë, Janinë, Lazarat, Gjirokastër, Itali, Shkrel, Sarandë, Elbasan, Konispol
1-31 Tetor 2011	30	6	0	0	3 (Lulzim Berisha)	0 opinione	Greqi, Berat, Vlorë, Korcë, Gjirokastër, Vlorë (Ura e Drashovicës), Elbasan, Sarandë, Tiranë, Itali, Ndroq (droga nga Lazarati), Lazarat, Elbasan, Qafë-Thanë
1-31 Mars 2011	34	6	1	0	0	0 opinione	Gjirokastër, Tiranë, Lazarat, Qafë-Botë, Romë, Marikaj, Athinë, Itali, Lazarat, Gjirokastër
1-31 Tetor 2010	8	2	1	0	0	0 opinione	Gjirokastër, Kurbini, Elbasan
1-31 Mars 2010	28	2	0	0	1 (Lazarat)	1 opinion: Koli Bele	Tiranë, Fier, Durrës, Sarandë, Shijak, Librazhd, Itali, Berat, Lazarat
1-31 Tetor 2009	12	4	1	1 (Lulzim Berisha)	0	0 opinione	Tiranë, Elbasan

### 3. Opinonet mbi kanabisin dhe drogat e tjera 2009-2020 bashkangjitur